



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.437/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesat e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Ferizaj, Bajram Tahiri nga radhët e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN si të parregullta ankesat ZL.A.nr.437/2017, ZL.A.nr.438/2017, ZL.A.nr.439/2017 dhe ZL.A.nr.440/2017, e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal të Ferizajt, Bajram Tahiri nga radhët e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, të paraqitura me datën 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar 4 (katër) ankesa nga Bajram Tahiri, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Ferizajt, nga radhët e subjektit politik NISMA, me të cilat pretendon se i janë keqpërdorur votat, në Qendrat e Votimit të Komunës së Ferizajt, si në: Manastirc, Vendvotim 2519D/01R, 2519D/02R, në Komogllavë, vendvotimet 251D/01R, 2510D/02R, 2510D/03R, 2510D/04R dhe 2510D/05R.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.437/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht rregullsinë e ankesave, gjeti se:

Ankesat janë të pa rregullta

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesat e parashtruara nga ana e Bajram Tahiri, nga radhët e NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, janë të parregullta, sepse nuk janë të nënshkruara nga Bajram Tahiri dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kriteret e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.6, ku përcaktohet se: Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozitat e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbështetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.437/2017 më datën 24.10.2017.



**Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.